



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.699/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtës Naim Shala, në konfliktin administrativ të paditëses, M.F.nga P., Rr."S." nr...., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAPK në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, jashtë seance, me dt.07.07.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, M.F.nga P.. Anulohet aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me numër dosje 5063556, i datës;04.04.2016 dhe çështja kthehet, në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Paditësja, M.F.nga P., ka ushtruar padi në këtë Gjykatë me datë;11.05.2016, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga Gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e tij, ta aprovon në tërësi si të bazuar, duke e anuluar si të kundërligjshëm, aktvendimin e të paditurës me numër dosje 5063556, i datës;04.04.2016 dhe çështjen ta kthen tek e paditura, në rishqyrtim dhe rivendosje, nga arsyet e dhëna në padi.

Me aktvendimin e të paditurës me numër dosje 5063556, i datës;04.04.2016, e paditura në dispozitivin e të njëjtit, ka refuzuar ankesën e paditëses të datës;09.03.2016, si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë, si plotësisht të bazuar në ligjin nr.2003/23.

Ndërsa, në arsyetimin e të njëjtit aktvendim, ka theksuar se, "Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së M.F.nga P., të datës;09.03.2016, në mënyrë të gjithanshme, në seancën e dt.29.03.2016, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt.20.01.2016, si dhe në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit për persona me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme". Poashtu në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhet se, "Komisioni ekspert mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, ka vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor, ku për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor, si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe e përhershme, siç përcaktohet me ligjin nr.2003/23". Me ç'rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Paditësja e pakënaqur me këtë aktvendim, i është drejtuar kësaj gjykate me padi, duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata shqyrtoi aktvendimin e goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se "Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në pergjigjen". Poashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të të njëjtit ligj i cili përcakton se "Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare".

Nga aktvendimi i kontestuar rrjedh se, ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton aktvendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore, në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e aryeve, duhet të jepen domosdoshmërisht, arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekun në një mënyrë apo tjetër, të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Nga aktvendimi i kundërshtuar, gjykata vëren se, në hyrje të të njëjtit dhe në arsyetimin e tij, e paditura e shqyrton ankesën e paditëses duke u bazuar në Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar Nr.2003/23, ligj ky, i cili është shfuqizuar me Ligjin Nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht neni 27.1.1.3. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, organi i paditur, gabimisht ka aplikuar ligjin material, kur paditëses i'a ka refuzuar ankesën, duke u bazuar në Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar Nr.2003/23, i cili ligj sipas Ligjit Nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është shpallur me dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës të datës 21.05.2014, kurse është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 05.06.2014, ndërsa ka hyrë në fuqi më dt. 20.06.2014, ku sipas sipas nenit 27.1.1.3, të të njëjtit ligj, është përcaktuar se “me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet ligji Nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (Rregullorja nr.2003/40 e UNMIK-ut) ”.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, organi i paditur, gabimisht kanë zbatuar ligjin material, kur ka vendosur lidhur me ankesën e paditëses, duke u bazuar në Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar nr.2003/23, i cili ligj ka qenë i shfuqizuar, në kohën e nxerrjes së aktvendimit të kontestuar nga paditësi, me Ligjin Nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Të metat e cakura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konflikte Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veprorë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i menjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, të Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.699/2016, dt.07.07.2017,

Procesmbajtës
Naim Shala

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.